



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:099036

Datë: 03.01.2024

Numri i dokumentit: 05151150

C.nr.1649/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.K. me numër personal nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson V.G. avokat nga Prizreni, kundër të paditurve M.M. me numër personal dhe N.M. me numër personal të dy nga fshati komuna e Prizrenit, me objekt të çështjes: pengim posedimi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor-publik, në prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij, si dhe të paditurit të dytë N.M. në mungesë të paditurit M.M. me datë 11.12.2023, mori, ndërsa më datë 03.01.2024, përpiloi me shkrim, këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit Sh.K. nga fshati Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të *“VËRTETOHET se të paditurit M.M. dhe N.M. nga fshati Landovicë, komuna e Prizrenit, me datë 28.04.2022, e kanë kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit Sh.K. në pjesën e shfrytëzimit të pronës kadastrale me numër P-71813041-..... ku kanë vendosur stuba, mrezha, pemë dhe gypa të ujit. URDHËROHEN të paditurit M.M. dhe N.M. që të pushojnë së penguari paditësin në pjesën e ngastrës kadastrale P-71813041-..... në pjesën ku e ka në shfrytëzim paditësi dhe ti heqin të gjitha pengesat e vendosura në hapësirë që shfrytëzohet nga paditësi ” si e pa bazuar.*
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Sh.K. nga fshati Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij V.G. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurve M.M. dhe N.M. të dy nga fshati komuna e Prizrenit, me objekt të çështjes: pengim posedimi.

- 1. Pretendimet e palëve;*

Në padi, i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi është posedues faktik i një pjese të paluajtshmërisë me numër kadastral P-71813041-..... me sipërfaqe të përgjithshme 234121 m², në të cilën ka të ndërtuar shtëpinë e tij të banimit, tokë pyjore mal i klasës së dytë, e evidentuar në emër të KBI Progres, pronësi shoqërore. Palët ndërgjyqëse janë komshijë që një kohë të gjatë dhe herë pas here kanë pasur mosmarrëveshje rreth shfrytëzimit të pjesës së hapësirës rreth shtëpive të tyre. Të njëjtit kanë pasur mosmarrëveshje rreth shfrytëzimit të pjesëve hapësinore, e në mënyrë që të mos kenë mosmarrëveshje në vazhdimësi të dyja palët janë pajtuar rreth pikave të vendosura nga ana e Kompanisë së gjeodetëve të licencuar. Të paditurit duke mos respektuar marrëveshjen e arritur mes tyre, me datë 28.04.2022, në pjesën të cilën paditësi e ka në posedim, vendosin stuba, mrezha pemë, dhe, e po ashtu kanë vendosur gypa të ujit duke e penguar paditësin që ta shfrytëzon pjesën e hapësirës të cilën kanë arritur marrëveshje. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadi e paditësit të aprovet në tërësi si e bazuar.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kryesor i autorizuari i palës paditëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadi e paditësit është ligjërish e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovet në tërësi si e bazuar, pasi që nuk është kontestuese se parcela që është objekt i këtij kontesti është në emër të KBI Progres, pronësi shoqërore, por edhe nuk është kontestuese se në shfrytëzimin faktik e ka këtu paditësi Sh.K. Por për paditësin është kontestuese se që nga data e marrëveshjes së arritur në mes paditësit dhe të paditurve, marrëveshje kjo e datës 25.03.2022, ku të njëjtit në një procesverbal kanë arritur që ti vendosin pikat e tyre kufizuese për shfrytëzimin e parcelave në fjalë, e kjo marrëveshje nuk është zbatuar nga ana e të paditurve. Po ashtu edhe ekspertiza e ardhur gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka konstatuar se kjo parcelë nga njëra anë është e rrethuar me shtylla betoni, shufra metalike dhe drunje, në të cilat janë të vendosura rrethojat metalike në formë të rrjetës, e po ashtu në anën tjetër është e rrethuar me kubëza betoni, mirëpo në atë ekspertizë nuk ka konstatuar se këto konstatime të këtyre gjësendeve a janë të vendosura sipas marrëveshjes së arritur mes palëve ndërgjyqëse të datës 25.03.2022. Gjate marrjes në pyetje të dëshmitarit L.K. nga fshati Landovicë, komuna e Prizrenit, në mes të tjerash ka deklaruar se “stubat nuk janë në të njëjtin vend me shufrat metalike pasi që palët janë marr vesh që stubat të largohen me vendosjen e murit, stubat kane qenë të vendosura në pjesën që e shfrytëzon paditësi”. Eksperti i gjeodezisë me plotësimin e ekspertizës së datës 15.09.2022, ndër te tjera ka theksuar se shufrat metalike dhe shtyllat prej betoni që gjenden në teren janë të vendosura në kufirin sipas skicës që gjendet në shkresat e lëndës, duke kërkuar që plotësimin të ekspertizës të mos i falet besimi, pasi që e njëjta nuk është punuar sipas kërkesës së tyre. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar, mirëpo të njëjtat nuk i ka specifikuar.

Të paditurit M.M. dhe N.M. të dy nga fshati me parashtresën e datës 29.07.2022, të paraqitur nëpërmjet të autorizuarit të tyre av. M.Sh. nga Prizreni, e kanë kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit Sh.K. duke theksuar se prona e kontestuar është shfrytëzuar nga babai i tyre

që më shumë se 30 vite. Tutje kanë theksuar se provat e paraqitura me padi, respektivisht fotot të cilat janë paraqitur si provë, janë të vitit 2013 dhe se të paditurit nuk e kanë kryer aktin e pengim posedimit.

I padituri Mehmet Morina, nuk ka marrë pjesë në vazhdimi e shqyrtimit kryesor të datës 22.11.2023 dhe datës 11.12.2023, andaj bazuar në nenin 423 par.4, të LPK-së, vazhdimi shqyrtimi kryesor i datës 22.11.2023 dhe datës 11.12.2023, është mbajtur në mungesë të të paditurit M.M. nga fshati Landovicë, komuna e Prizrenit.

I padituri M.M. në shqyrtimin kryesor të mbajtur më datë 26.06.2023 ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit pasi që gjendja faktike në teren nuk ka asnjë lëvizje, në kohën kur pretendohet se ka ndodhë akti i pengim posedimit.

I padituri N.M. edhe përgjatë shqyrtimit kryesor e ka kundërshtar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pas administrimit të provave dhe atë të ekspertizës të punuar nga eksperti i gjeodezisë D.B. është vërtetuar fakti se të paditurit nuk kanë penguar respektivisht nuk kanë kryer aktin e pengim posedimit. Mbi këtë bazë, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

2. Gjendja faktike e vërtetuar;

Gjykata, për ta vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike-kontestimore, gjatë shqyrtimit kryesorë, ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave si në vijim: dëgjimi i dëshmitarëve S.K. dhe L.K. në shqyrtimin e datës 26.06.2023; ekspertizën e gjeodezisë të datës 15.09.2022, të punuar nga eksperti i gjeodezisë D.B. ekspertizën plotësuese të përpiluar nga eksperti D.B. të datës 02.10.2023, të dorëzuar në gjykatë 06.11.2023, si dhe deklarimi i ekspertit në shqyrtimin e datës 22.11.2023; certifikatën për njësinë kadastrale P-7183041-..... të datës 10.05.2022; kartelën e viktimës me nr. të rastit 2022 – GL-209, data e paraqitjes së rastit 09.05.2022; procesverbalin nga tereni i datës 25.03.2022, i përpiluar nga kompania e licencuar gjeodete “Geo Prizma SHPK”; skicat e përpiluar nga “Geo Prizma SHPK”, datë 26.03.2022, të cilat në shkresat e lëndës mbajnë numra 9 dhe 10; setin e fotografive 5 sosh, të cilat në shkresat e lëndës mbajnë numrat 11-15; setin e fotografive 12 foto, në 6 faqe të cilat në shkresat e lëndës mbajnë numrat 33-38.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e **pa bazuar**.

Gjykata në shqyrtimin e datës 26.06.2023, ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve S.K. dhe L.K. Nga dëgjimi i dëshmitarit S.K. gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka qenë prezent në kohën kur Geo Prizma ka bërë evidentimin e gjendjes faktike në teren dhe janë bërë matjet e pjesëve të

ngastrave kadastrale të cilat i shfrytëzojnë palët ndërgjyqëse dhe se atë ditë palët ndërgjyqëse kishin arritur marrëveshjen për shfrytëzimin e sipërfaqes. Pjesa e hapësirës para dhe pas vendosjes së pikave është shfrytëzuar nga paditësi dhe se hapësira në mes të paditësit dhe të paditurve është e ndarë me stuba, mrezhë dhe pemë. Nga dëgjimi i dëshmitarit L.K. gjykata vërtetoi faktin se hapësira mes paditësit dhe të paditurit është e ndarë me mrezhë metalike dhe stuba, si dhe të njëjtat janë vendosur pasi që ka qenë Geo Prizma SHPK. Pjesën deri te vendosja e shufrave metalike e ka shfrytëzuar dhe e shfrytëzon paditësi.

Nga leximi i ekspertizës së gjeodezisë të datës 15.09.2022, të punuar nga eksperti i gjeodezisë D.B. gjykata vërtetoi faktin se parcela me numër 00853-0 ZK Landovicë, gjendet në pjesën jug-perëndimore të Zonës Kadastrale Landovicë. Gjatë identifikimit në terren është konstatuar se pjesa e parcelës e cila është objekt i këtij kontesti është e lirë dhe nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt brenda kufijve faktik të saj, e njëjta nga ana lindore, jugore dhe perëndimore e saj është e rrethuar pjesërisht me shtylla prej betoni, shufra metalike dhe drunjë, në të cilat janë të vendosura rrethoja metalike në formë të rrjetës, po ashtu nga ana perëndimore kjo pjesë e parcelës kufizohet me rrugë të kubëzuar. Parcela kadastrale nr..... ZK Landovicë, me kulturë Mal e klasës së 2, me sipërfaqe prej 234121 m², evidentohet në emër të P. Sh-KIB PROGRES.

Nga leximi i ekspertizës plotësuese të përpiluar nga eksperti D.B. të datës 02.10.2023, të dorëzuar në gjykatë 06.11.2023, gjykata konstatoi se eksperti ka bërë matjet në terren dhe gjendja e matur është krahasuar me gjendjen e skicës e cila gjendet në shkresat e lëndës, ku pas këtij krahasimi është konstatuar se shufrat metalike dhe shtyllat e betonit që gjenden në terren, janë në kufirin sipas skicës që gjendet në shkresat e lëndës. Gjykata në shqyrtimin e datës 22.11.2023, ka bërë dëgjimin e ekspertit të gjeodezisë D.B. i cili pas pyetjeve të parashtruara nga i autorizuari i paditësit, ka deklaruar se: katër pikat rrethore me ngjyrë të kuqe të cilat gjenden në faqen tre të ekspertizës së plotësuar janë pjesë përbërëse e kufijve faktik për të cilat palët në procedurë para kësaj procedure gjyqësore i kanë vendosur në formë të kufirit mes tyre, të njëjtat janë vetëm katër edhe pse në skicën e cila gjendet në shkresat e lëndës ka më shumë, duke përsëritur faktin se kufijtë faktik përshtaten dhe përputhen me kufijtë që gjenden në skicën e datës 26.03.2022, e cila gjenden në shkresat e lëndës. Në teren ka shufra metalike, ka shtylla të betonit, ka drunjte të ngulitura apo të vendosura në pozitë vertikale por nuk e ka bërë numërimin e tyre pasi që qëllimi kryesor ka qenë që të konstatohet se a ka lëvizje të kufijve faktikë, në raport me skicën që gjendet në shkresat e lëndës. Gjatë kohës së matjes është vërejtur se nga njëra anë e kufirit pjesërisht gjendet një shembje e dheut por jo në masë të konsiderueshme, por e njëjta shembje është vërejtur se nuk ka ndikuar në lëvizjen e kufirit faktik.

Nga leximi i certifikatës për njësinë kadastrale P-7183041-..... të datës 10.05.2022, gjykata vërtetoi faktin se ngastrave kadastrale me numër 00853-0, tokë pyjore, Mal i klasës 2, me sipërfaqe 234121 m², evidentohet në emër të PASURIA SHOQËRORE KIB PROGRES pjesa e pronës 1/1.

Gjykata ka bërë leximin e kartelës së viktimës me nr. të rastit 2022 – GL-209, me të cilën konstatohet se me datë 09.05.2022, është paraqitur rast në Stacionin Policor në Veri.

Nga leximi i procesverbalit nga tereni i datës 25.03.2022, i përpiluar nga kompania e licencuar gjeodete “Geo Prizma SHPK”, gjykata vërtetoi faktin se me datë 25.03.2022, me kërkesë të Sh.K. është bërë ingjizimi i gjendjes faktike të pjesës së parcelës ZK Landovicë. Gjatë matjes së pjesës të cilën e shfrytëzon Sh.K. kanë qenë prezent edhe pronarët e parcelave fqinje, të cilët janë pajtuar për pikat e matura dhe kanë nënshkruar në procesin e terrenit të datës 25.03.2022. Këtë procesverbal e kanë nënshkruar edhe këtu paditësi Sh.K. si dhe të paditurit N.M. dhe M.M.

Nga leximi i skicave të përpiluar nga “Geo Prizma SHPK”, datë 26.03.2022, të cilat në shkresat e lëndës mbajnë numra 9 dhe 10, gjykata konstatoi se të njëjtat përmbajnë kufirin kadastral dhe kufirin e gjendjes faktike, për ngastrën kadastrale me numër ZK Landovicë

Gjykata ka bërë shikimin e setit të fotografive 5 sosh, të cilat në shkresat e lëndës mbajnë numrat 11-15, si dhe shikimin e setit të fotografive 12 foto, në 6 faqe të cilat në shkresat e lëndës mbajnë numrat 33-38, në të cilat vërehen sipërfaqja kontestuese dhe mënyra e rrethimit të saj.

3. Baza ligjore

Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS), parashihet se “*personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*”. Me nenin 113 par. 1 të këtij ligji është paraparë se “*nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta*” ndërsa në par. 2 të këtij neni ceket se “*nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore*”. Në lidhje me këtë çështje juridike, gjykata duke u bazuar në nenin 480 të LPK-së, është kufizuar vetëm në *konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit.*

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga provat e administruara dhe në bazë të fakteve të vërtetuara, nuk është kontestuese që ngastra kadastrale me numër P-71813041-..... ZK Landovicë, me sipërfaqe prej 234121 m², evidentohet në emër të pasuria shoqërore KBI Progres dhe se një pjesë e kësaj ngastre shfrytëzohet nga ana e paditësit. Po ashtu nuk është kontestues fakti se palët ndërgjyqëse janë fqinjë në mes vete dhe se të njëjtit me datën 25.03.2022, kishin bërë matjen e pjesëve të cilat i shfrytëzojnë në ngastrën kadastrale kontestuese, duke i caktuar kufijtë e gjendjes faktike dhe se ngastrat të cilët të njëjtit i shfrytëzojnë janë të ndara me shtylla betoni, shufra metalike dhe drunjë, në të cilat janë të vendosura rrethoja metalike në formë të rrjetës. Kontestuese për gjykatën mbetet fakti nëse të paditurit M.M. dhe N.M. me datë 28.04.2022, e kanë kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit Sh.K. në pjesën e shfrytëzimit të pronës kadastrale me numër P-71813041-..... ku kanë vendosur stuba, mrezha, pemë dhe gypa të ujit.

Në këtë drejtim, sipas provave të administruara në këtë procedurë, gjykata ka vërtetuar faktin se kërkesëpadia e paditësit nuk është e bazuar dhe e njëjta është refuzuar në tërësi, sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Në bazë të fakteve, provave e arsyeve të theksuara, nuk është provuar se më datë 28.04.2022, të ketë pasur ndonjë akt të pengim posedimit nga të paditurit ndaj paditësit.

Përkatësisht, gjykata së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka dalë në vend të ngjarjes dhe është bërë identifikimi i ngastrës kontestuese, eksperti ka bërë matjet në terren dhe gjendja e matur është krahasuar me gjendjen e skicës e cila gjendet në shkresat e lëndës, ku pas këtij krahasimi është konstatuar se shufrat metalike dhe shtyllat e betonit që gjenden në terren, janë në kufirin sipas skicës që gjendet në shkresat e lëndës e datës 26.03.2023, e cila është punuar nga GeoPrizma SHPK, sipas marrëveshjes së këtu palëve ndërgjyqëse. Po ashtu, gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve S.K. dhe L.K. të cilët kanë deklaruar se hapësira kontestuese është shfrytëzuar nga paditësi dhe vazhdon të shfrytëzohet nga ai dhe se kufiri faktik i hapësirave të cilat i shfrytëzojnë palët ndërgjyqëse janë të përcaktuara me shufra metalike dhe të njëjtat janë vendosur pas matjes së bërë nga Geo Prizma SHPK. Deklaratave të dëshmitarëve të cekur si më lartë, gjykata ia kishte falur besimin e plot pasi që ato janë në përputhje me njëra tjetrën dhe me prova tjera të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës. Gjykata, në shqyrtimin e datës 22.11.2023, ka bërë dëgjimin e ekspertit të gjeodezisë, i cili pas plotësimit të ekspertizës së gjeodezisë, ka deklaruar se kufijtë faktik të cilat palët ndërgjyqëse para kësaj procedure gjyqësore i kanë vendosur në formë të kufirit mes tyre përshtaten dhe përputhen me kufijtë që gjenden në skicën e datës 26.03.2022, e cila gjenden në shkresat e lëndës. Në teren ka shufra metalike, ka shtylla të betonit, ka drunjte të ngulitura apo të vendosua në pozitë vertikale dhe gjatë kohës së matjes është vërejtur se nga njëra anë e kufirit pjesërisht gjendet një shembje e dheut por jo në masë të konsiderueshme, por e njëjta shembje është vërejtur se nuk ka ndikuar në lëvizjen e kufirit faktik.

Në rastin konkret, të gjitha provat e lartpërmendura argumentojnë se të paditurit nuk kanë ndërmarr asnjë veprim me të cilin kanë kryer aktin e pengim posedimit ashtu siç pretendon pala paditëse. Gjykata ka gjetur se pretendimet e paditësit, se të paditurit me datë 28.04.2022, e kanë kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit, në pjesën e shfrytëzimit të pronës kadastrale me numër P-71813041-.... ku kanë vendosur stuba, mrezha, pemë dhe gypa të ujit, janë të pa bazuara, për faktin se me asnjë provë të vetme paditësi nuk ka arritur që të vërtetojë faktin se këto objekte (stuba, mrezha, pemë dhe gypa të ujit) janë vendosur me datë 28.04.2022, dhe është penguar paditësi në shfrytëzimin e ngastrës kadastrale kontestuese. Kjo për faktin se edhe me dëgjimin e dëshmitarëve është konstatuar se të njëjtat janë vendosur sipas marrëveshjes së këtu palëve ndërgjyqëse pas matjeve të cilat i kanë bërë të njëjtat, e bazuar në ekspertizën e gjeodezisë të datës 15.09.2022 dhe plotësimit të ekspertizës së datës 02.10.2023, të dorëzuar në gjykatë me datë 06.11.2023, është vërtetuar se shufrat metalike dhe shtyllat e betonit që gjenden në terren, janë në kufirin sipas skicës që gjendet në shkresat e lëndës. Duke u bazuar në nenin 7 paragrafi 1 të LPK-së, në të cilin është paraparë se *“Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, dhe në nenin 319 paragrafi 1 të LPK-së, ku është paraparë se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Barra e të provuarit në rastin konkret bije mbi paditësin i cili në rastin konkret gjykatës nuk i ka ofruar prova konkrete me të cilat do të vërtetohej se të paditurit e kanë kryer aktin e pengim posedimit ndaj këtu paditësit në shfrytëzimin e ngastrës kadastrale ZK Landovicë. Duke i marr për bazë të lart cekura gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me padi të pengim posedimit, ku gjykata bënë vlerësimin e gjendjes së fundit faktike të posedimit dhe aktit të pengimit. Sipas nenit 480 të LPK-së, ndër të tjera theksohet se gjykata lidhur me çështjet për shkak të pengimit të posedimit kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të aktit të pengimit të bërë. Pra, kushti i parë është të bëhet vlerësimi i gjendjes së fundit faktike dhe kushti i dytë të bëhet vlerësimi i vet aktit të pengimit. Kësisoj, paditësi ka arritur të vërtetoj se i njëjti ushtron pushtetin e fundit faktik mbi sendin (gjendja e fundit e posedimit), mirëpo i njëjti gjykatës nuk ia ka provuar ekzistimin e kushtit të dytë, përkatësisht të vërtetoi se ka ndodhur veprimi i kundërligjshëm dhe pengimi i posedimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit këtij aktvendimi, bazuar në nenit 450 të LPK-së, për shkak se pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 142.3, lidhur me nenin 480 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1649/2022, datë 03.01.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.